



## **Njoftim për shtyp, datë 29 Maj 2023**

29 May, 2023 by **KLGJ** in **NJOFTIME PËR SHTYP**

Sot, në datë 29.05.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor zhvilloi Mbledhjen Plenare të radhës, në të cilën shqyrtoi çështjet si më poshtë:

Këshilli miratoi disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 557, datë 29.12.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisioneve të Ristrukturimit”.

Këshilli miratoi vendimin për caktimin e numrit të gjyqtarëve në gjykatat administrative të shkallës së parë.

Më tej, Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë, të shpallur me vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, për kandidatin z. Sokol Ibi, për shkak të tërheqjes nga kandidimi.

**Në kuadër të procesit të plotësimit të pozicioneve të lira në gjykata, Këshilli vendosi ngritjen në detyrën e gjyqtares së Gjykatës Administrative të Apelit të znj. Enerjeta Shehaj.**

*Informacioni i mësipërm është marrë në faqen zyrtare të KLGJ, në linkun: <https://klgj.al/2023/05/njoftim-per-shtyp-date-29-maj-2023/>*